



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E LARTË

Nr. 3768 Prot.,

Datë 11/07/2025

SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE “SPECIALIST I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE NË SEKTORIN E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE PROKURIMEVE”

Në mbështetje të neneve 54, 55, 56, 57, 58, 60, 62, të ligjit nr. 98/2016 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vendimit nr. 622, datë 10.12.2020 "Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor", udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nëpërmjet konkurrimit të hapur", dhe shkresës nr.3750/1 prot., datë 04.07.2025 të KLGJ-së, Gjykata e Lartë shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe atë të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

- I. 1 (një) pozicion vakant - Specialist i Shërbimeve Mbështetëse në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve, kategoria ekzekutive, IV-1.**

Pozicioni si më sipër u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele rezulton ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë.

Afati për dorëzimin e dokumenteve për:

LËVIZJE PARALELE

24 korrik 2025

Afati për dorëzimin e dokumenteve për:

Përshkrimi i përgjithshëm i punës dhe detyrat për pozicionin “Specialist i Shërbimeve Mbështetëse në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve”, është:

- Merr masa për riparimin dhe shërbimet e nevojshme për mirëmbajtjen e godinës, zyrave, pajisjeve dhe aparaturave. Kur konstatohet se dëmtimet e tyre kryhen me faj, nxjerr përgjegjësitë dhe parashtron propozimet për zhdëmtim;
- Kontrollon përdorimin me korrektësi të mjeteve, pajisjeve dhe automjeteve, si dhe ndalon çdo keqpërdorim e shfrytëzim abuziv të tyre;
- Merr masa për t'i plotësuar personelit të gjykatës kërkesat për materiale të nevojshme kancelarike dhe çdo pajisje tjetër;
- Në bashkëpunim me përgjegjësin e sektorit kujdeset dhe koordinon punën për plotësimin e kërkesave për karburant e pjesë këmbimi të automjeteve të institucionit dhe siguron gatishmërinë e mjeteve, kujdeset për kryerjen e punimeve dhe shërbimeve për mirëmbajtjen e ndërtesës dhe të zyrave, për sigurimin me energji elektrike dhe lidhje telefonike, si dhe për krijimin e lehtësirave të nevojshme për veprimtarinë e gjykatës;
- Kryen detyra të tjera, sipas urdhrave apo porosive të Këshillit të Gjykatës, të Kryetarit, dhe Kancelarit;
- Siguron raportim në kohë dhe në formën e duhur tek shefi i sektorit dhe kancelari për çështje të shërbimeve mbështetëse të gjykatës;
- Kontribuon në përgatitjen e materialeve apo të shkresave sipas detyrave të ngarkuara nga eprorët;
- Trajton çështje që kanë të bëjnë me shërbimet mbështetëse të gjykatës;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e mjediseve të brendshme dhe të jashtme të gjykatës;
- Punon brenda procedurave dhe orientimeve të përcaktuara nga Kryetari dhe Kancelari;

I. LËVIZJA PARALELE

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori, në të gjitha gjykatat pjesë e shërbimit civil gjyqësor.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) Të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon, IV- I (dokument nga institucioni);

- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (dokument nga institucioni);
- c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit "Mirë" ose "Shumë mire"

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Arsimi:

Të jetë i diplomuar në shkenca inxhinierike në nivelin "Master Profesional" ose "Master Shkencor".

Përvoja:

Të ketë punuar të paktën 3 (tre) vjet në pozicion të njëjtë ose të ngjashëm në gjykata ose institucione të sistemit të drejtësisë.

Aftësi të tjera:

- Të zotërojë shumë mirë një gjuhë të huaj - preferohen gjuhët e BE;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe organizative;
- Të ketë njohuri në përdorimin e programeve të Microsoft-Word dhe Excel.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë sipas procedurës së lëvizjes paralele në ambientet e Gjykatës së Lartë, në adresën: Rruga "Ibrahim Rugova " nr. 10, Tiranë ose nëpërmjet shërbimit postar dokumentet si më poshtë:

- a) Letër motivimi;
- b) Jetëshkrim të plotësuar (CV) në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhëzime-manuale/60-jetëshkrim-i-standard>
- c) Fotokopje të noterizuar të diplomës; për diplomat jashtë vendit duhet të jetë kryer procesi i njohjes pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi;
- d) Fotokopje të noterizuar të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë vitet e punësimit);
- e) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g) Formular vetëdeklarimi të gjendjes gjyqësore;
- h) Vlerësim i fundit nga eprori direkt;
- i) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

- j) Akt deklarimi lidhur me statusin e nëpunësit civil gjyqësor të konfirmuar në detyrë brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- k) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikimin e kandidatit.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Brenda datës 28.07.2025 Kancelari do të shpallë në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor www.klgj.al, dhe të Gjykatës së Lartë, www.gjykataelarte.al listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për procedurën e lëvizjes paralele si dhe vendin, datën dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Këshilli i Gjykatës.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Kancelari, përmes adresës së email-it, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët e skualifikuar paraqiten në Gjykatë brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesit marrin përgjigje brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

1.4 FUSHA E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen për njohuritë mbi:

- Ligjin nr. 98/2016 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
- Ligjin nr. 96/2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Kodin e Punës;
- Ligjin nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 49, datë 03.05.2012 "Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike".

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATIT

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Këshilli, brenda 2 (dy) ditëve nga përfundimi i verifikimit paraprak dhe i procedurave të ankimit, fillon vlerësimin profesional të kandidatëve. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind) dhe shpërndahen si me poshtë:

- a) 40 (dyzet) pikë për rezultatet e vlerësimit në punë;
- b) 50 (pesëdhjetë) pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përvojës së përgjithshme të përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës,
- c) 10 (dhjetë) pikë për trajnime apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURRIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Kancelari njofton individualisht me email kandidatët për rezultatin e tyre.

Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim, me postë ose elektronikisht në Këshill, për rezultatet e vlerësimit, brenda 2 (dy) ditëve nga data e njoftimit individual mbi rezultatin.

Ankimet shqyrtohen brenda 2 (dy) ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

Këshilli, brenda 24 (njëzet e katër) orëve, pas përfundimit të procedurave të ankimit, bën emërimin e kandidatit me më shumë pikë nga lista e hartuar.

Këshilli, kur emërohet nëpunësi civil gjyqësor i ri, brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i procedurës së lëvizjes paralele, njofton KLGJ për rezultatet e procedurës.

Njoftimi me emrat e nëpunësve fitues shpallet në faqen zyrtare të KLGJ dhe në faqen zyrtare të Gjykatës.

Nëse asnjë nga kandidatët nuk ka fituar mbi 70 pikë, Këshilli përfundon me vendim procedurën pa asnjë të përzgjedhur dhe njofton KLGJ brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga marrja e vendimit.

II. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të KLGJ, dhe të Gjykatës duke filluar nga data 05.08.2025.

11.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR DHE KRITERET E VEÇANTA

Sipas nenit 55 të ligjit nr. 98/2016 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil gjyqësor, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojnë kandidatët në procedurën e pranimi në shërbimin civil gjyqësor janë:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e ndonjë kundërvajtjeje penale me dashje;
- f) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil apo shërbimi civil gjyqësor, që nuk është shuar sipas ligjit.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Arsimi dhe Përvoja:

- Të jetë i diplomuar në shkenca inxhinierike, cikli i plotë i studimeve.
- Të ketë kryer "Master Profesional" në degën e inxhinierisë së ndërtimit ose të ngjashme
- Të ketë të paktën 3 vjet përvojë pune si inxhinier ndërtimi, kryesisht në zbatim.

Aftësi të tjera:

- Të zotërojë një gjuhë të huaj (anglisht, frëngjisht, italisht);
- Të ketë iniciativë për të përmirësuar kushtet dhe mjediset e punës;
- Të ketë aftësi komunikuese dhe organizative;
- Të ketë njohuri mesatare në përdorimin e programeve të Microsoft-Word dhe Excel.

11.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a) Letër motivimi;
- b) Jetëshkrim i aplikantit (CV) në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: [https:// www.dap.gov.al/le2:jislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard](https://www.dap.gov.al/le2:jislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard)
- c) Fotokopje të noterizuar të diplomës; për diplomat jashtë vendit duhet të jetë kryer procesi i njohjes pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi;
- d) Fotokopje të noterizuar të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë vitet e punësimit);
- e) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- t) Vërtetim i gjendjes shëndetësore;
- g) Formular i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;
- h) Vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor penal;
- i) Vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale;
- j) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

Për procedurën e pranimi në shërbimin civil gjyqësor, kandidatët duhet të paraqesin zyrtarisht dokumentet brenda datës 31.07.2025, në ambientet e Gjykatës së Lartë, në adresën: Rruga "Ibrahim Rugova" nr. 10, Tiranë ose përmes shërbimit postar.

11.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Brenda datës 05.08.2025 Kancelari i Gjykatës do të shpallë në faqen zyrtare të KLGIJ www.klgj.al dhe të Gjykatës së Lartë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e pranimi në shërbimin civil gjyqësor dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e pranimi në shërbimin civil gjyqësor dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Kancelari, përmes adresës së email-it, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

11.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim mbi njohuritë në lidhje me:

- Ligjin nr. 98/2016 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
- Ligjin nr. 96/2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë ", i ndryshuar;
- Kodin e Punës;
- Ligjin nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 49, datë 03.05.2012 "Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike ".

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;
- b) Përvojën e tyre të mëparshme;
- c) Motivimin dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

11.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATIT

Kandidatët do të vlerësohen:

- a) 60 (gjashtëdhjetë) pikë për testimin me shkrim.
- b) 40 (dyzet) pikë për intervistën e strukturuar me gojë nga Këshilli i Gjykatës.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURRIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve do të shpallet fituesi në faqen zyrtare të KLGJ dhe në faqen e Gjykatës. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen për rezultatet, individualisht përmes adresës së email-it.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e KLGJ dhe të Gjykatës, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë ekzekutive.

-Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;

-Për datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në menyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Lartë Gjyqësor www.klgj.al dhe atë të Gjykatës, www.gjykataelarte.gov.al , nga data 05.08.2025.

Detaje të mëtejshme në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në udhëzimin nr. 85, datë 11.03.2021 *"Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor përmes procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor"* të Këshillit të Lartë Gjyqësor publikuar në faqen zyrtare www.klgj.al.

KËSHILLI I GJYKATËS

GJYKATA E LARTË